

**Njoftim për përqendrim me të cilin Erste Aset Manaxhment GmbH, Austri do të fitojë kontroll mbi
INTERKEPITAL ASET MANAXHMENT sh.p.k, Kroaci**

(lënda nr. 08-168/2024)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më datë 25.12.2024, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës ka marrë njoftim për përqendrim me të cilin Erste Aset Manaxhment GmbH, shoqëri austriake, me seli të korporatës në Vjenë dhe adresë biznesi në Am Belvedere 1, 1100 Vjenë, Austri do të fitojë kontroll mbi INTERKEPITAL ASET MANAXHMENT sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas ligjeve të Kroacisë, me seli në rrugën Masarykova nr. 1, Zagreb, Kroaci.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit :

Erste Asset Management GmbH me veprimtari kryesore që përbëhet nga aktivitete të menaxhimit të aseteve është pjesë e grupit të kompanive Erste ("**Grupi Erste**"), një nga ofruesit më të mëdhenj të shërbimeve financiare në Evropën Qendrore dhe Lindore, që ofron shërbime bankare për individë dhe persona juridikë, si dhe shërbime financiare. Veprimtaria e Grupit Erste është e ndarë në bankë për individë, bankë komerciale, tregje të grupit, menaxhim aktiv dhe pasiv dhe qendër lokale për transaksione komerciale, bankë të besuar, si dhe qendër për transaksione komerciale në nivel grupi. Megjithatë, veprimtaria kryesore e Grupit Erste është ofrimi i shërbimeve bankare për individë dhe persona juridikë.

Vetë Erste Aset Manaxhment GmbH nuk është e pranishme në Maqedoninë e Veriut dhe nuk gjeneron qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

Grupi Erste është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes personave juridikë të lidhur dhe gjeneron qarkullim në Maqedoninë e Veriut:

1. Shparkase Banka SHA Shkup, me seli në Vasil Iloski 14, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, veprimtaria kryesore e së cilës është ndërmjetësim tjetër monetar.
2. Shparkashse Lizing SHPK Shkup me seli në rr. Maqedonia 34, Shkup, Maqedonia e Veriut, veprimtaria kryesore e së cilës është lizing financiar.
3. S-AMC1 SHPKNJP Shkup - në likuidim me seli në Vasil Iloski 14, Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, veprimtaria kryesore e së cilës është blerja dhe shitja e pasurive të saj të paluajtshme.

INTERKEPITAL ASET MANAGEMENT sh.p.k, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ka si veprimtari kryesore themelimin dhe menaxhimin e fondeve alternative të investimeve.

INTERKEPITAL ASET MANAXHMENT sh.p.k nuk është e pranishme në Maqedoninë e Veriut dhe nuk gjeneron qarkullim në Maqedoninë e Veriut.

Për qëllimet e këtij Njoftimi, Pjesëmarrësit propozojnë që tregu relevant i produkteve të përcaktohet si treg për menaxhimin e mjeteve.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni ka përcaktuar se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr.54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga data e publikimit të këtij njoftimi.

08.01.2025

Shkup